



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.50, datë 18.03.2022

PËR MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT

Bazuar në nenin 65, pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në kërkesën për dorëheqje nga detyra të znj. Esmeralda Maillard (Ndoci), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, nëpërmjet kërkesës së regjistruar me Nr. 547 prot, datë 07.03.2022, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak dorëheqje për **Znj. Esmeralda Maillard (Ndoci)**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.
2. Dorëheqja jep efekt më datë 30.04.2022.
3. Të njoftohen për këtë vendim Znj. Esmeralda Maillard (Ndoci), Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më datë 18.03.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ZËVENDËSKRYETAR  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
SOKOL STOJANI

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

ANËTAR  
ELOIDA GÖXHI

ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

ANËTAR  
ZEQIR HODA

ANËTAR  
SANDËR BECI

ANËTAR  
TARTAR BAZAJ

ANËTAR  
LUDOVIK DODAJ

ANËTAR  
MIRELA BOGDANI